

MINISTRIA E KULTURËS

RAPORTET E MONITORIMIT

12 - MUJORI - VITI 2014

Programet Buxhetore:

- 1. Planifikim Administrim, Menaxhim**
- 2. Trashëgimia Kulturore**
- 3. Arti dhe Kultura**

RELACION**MBI MONITORIMIN E SHPENZIMEVE BUXHETORE TË VITIT 2014**

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 160/2014, “Për Buxhetin e vitit 2015”, Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” Udhëzimit Plotësues nr.2 datë 9.1.2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015” paragrafi IV “Monitorimi” Ministria e Kulturës, për 12-mujorin e vitit 2014, ka menaxhuar dhe vlerësuar me përparësi të veçantë procesin e monitorimit të zbatimit të fondeve buxhetore.

Me anë të këtij relacioni prezantojmë në mënyrë të detajuar informacionin mbi realizimin e buxhetit për 12 - **mujorin e vitit 2014**, ndarë sipas programeve dhe zërave ekonomikë.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas programeve buxhetore

Nr	Emri i programit	Plani 12- mujori 2014		Realizimi 12- mujori 2014		
		Në (000) leke	Struktura ne (%)	Në (000) leke	Struktura në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
1.	Planifikim, Menaxhim, Administrim	268,262	13.26%	239,279	13.72%	89.20%
2.	Trashëgimia Kulturore	795,158	39.31%	591,011	33.88%	74.33%
3.	Arti dhe Kultura	959,466	47.43%	914,146	52.40%	95.28%
	Totali	2,022,886	100.0%	1,744,436	100.0%	86.24%
	Financimi i huaj per investime	0	0	0	0	0
	Totali me Financimet e huaja	0	0	0	0	0

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se, buxheti është realizuar në masën 86 %, ku rreth 47 % të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit “Arti dhe Kultura” buxheti i të cilit është realizuar në masën 95 %, ndjekur nga programi ”Trashëgimia Kulturore shpenzimet e të cilit zënë rreth 39 % të totali dhe janë realizuar në masën 74 %, programi ”Planifikim Menaxhimi” shpenzimet e të cilit zënë rreth 13 % dhe janë realizuar në masën 89% .

Realizimi i fondeve buxhetore sipas zërave ekonomike

G r	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 12- mujori 2014		Realizimi 12- mujori 2014		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	857,457	42.4%	828,088	47.5%	96.6%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	613,531	30.3%	555,859	31.9%	90.6%
12	01110	231	Kapitale	551,898	27.3%	360,489	20.7%	65.3%
			TOTALI	2,022,886	100	1,744,436	100	86.2%
12	01110	231	Jashtë buxhetore					
			TOTALI	2,022,886	100	1,744,436	100	86.2%

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se shpenzimet për 12-mujorin e vitit 2014 për paga dhe sigurime shoqërore janë realizuar në masën 97%, shpenzimet korentë 91 %, dhe shpenzimet kapitale, janë realizuar në masën 65 %.

Mosrealizimi i fondeve buxhetore në masën 13.8% ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i fondeve për investime.

Më poshtë po analizojmë realizimin e buxhetit sipas zërave dhe produkteve për çdo program buxhetor.

1. Programi: "PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM"

Për fondet e këtij programi, konstatohet planifikimin dhe shpenzimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 12- mujori 2014		Realizimi 12- mujori 2014		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	81,800	30.5%	71,113	29.7%	86.9%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	180,147	67.2%	162,610	68%	90.3%
12	01110	231	Kapitale	6,315	2.4%	5,555	2.3%	88%
			TOTALI	268,262	100	239,279	100	89.2%

Sikurse vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se buxheti është realizuar në masën 89%, shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 31 % të totalit dhe janë realizuar në masën 87%. Shpenzimet korrente zënë rreth 67% të totalit dhe janë realizuar në masën 90%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 2% të totalit dhe janë realizuar në masën 88%. Mosrealizimi i fondeve në masën 10.8% konstatohet kryesisht në shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore.

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në shtatë produkte, planifikimi dhe realizimi i të cilave, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme. Sikurse vihet re nga të dhënat, konstatohet realizimi i produkteve.

në (000) lekë

Programi	Planifikim, Menaxhim, Administrim				01110
Kodi i Produktit	Shpenzimet e Produktit				
	Emri Produktit	PBA Plan 2014	Buxhet Plan 2014	Buxhet/Plan 12-mujori 2014	Buxhet/Fakt 12-mujori 2014
A-02113	Paisje elektronike dhe elektrike		23,500	95,812	94,550
B-01415	Pajisje zyrash		25,500	0	0
C-02459	Akte ligjore e nenligjore		16,000	15,800	15,200
D-02461	Ristrukturim I strukturave aktuale		15,000	15,000	15,000
E-04177	Pagesa vendimesh gjyqësore		16,000	69,800	65,029
F-04248	Auditime		20,000	49,500	49,500
G-02496	Aktmarveshje		22,900	22,350	0
	Totali		138,900	268,262	239,279

Nga sa mësipër rezulton se produktet e listuara nën këtë program janë realizuar pjesërisht. Në lidhje me realizimin e produkteve informojmë se procesi i ristrukturimit është kryer brenda numrit të përgjithshëm të MK-së në zbatim të Ligjislacionit në fuqi.

Për sa i përket produktit “Paisje elektronike dhe elektrike” për këtë 12 muor ka patur planifikim njëkohësisht dhe realizim si pasojë e ndërrimit të Godinës së MK në Kinostudio.

Gjatë 12 mujorit të vitit 2014 realizimi i produkti “Akte ligjore dhe nenligjore” janë planifikuar disa projekt vendime (shtese fondesh) me rastin e 70-Vjetorit të Çlirimit.

Në realizimin e Produktit “Nënshkrim Marrëveshjesh” gjatë këtij 12 mujori nuk është nënshkruar asnjë marrëveshje

Në realizimin e Produktit “Auditime” gjatë këtij 12 mujori janë planifikuar dhe janë audituar disa subjekte përmendim këtu: DRKK Sarandë, Z.K.A.P Shkodër etj.

Gjatë 12 mujorit të këtij viti, janë likuiduar një pjesë e vendimesh gjyqësore të viteve të kaluara dhe një pjesë e vitit aktual.

2. Programi: "TRASHËGIMIA KULTURORE DHE MUZETË"

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 12- mujori 2014		Realizimi 12- mujori 2014		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	256,124	32.2%	249,316	42.2%	97.3%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	152,823	19.2%	139,833	23.7%	91.5%
12	01110	231	Kapitale	386,211	48.6%	201,862	34.2%	52.3%
			TOTALI	795,158	100%	591,011	100%	74.3%
12	01110	231	Jashtë buxhetore	0	0	0	0	0
			TOTALI	795,158	100%	591,011	100%	74.3%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 74%. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 32 % të totalit dhe janë realizuar në masën 97%, shpenzimet korrente zënë rreth 19% të totalit dhe janë realizuar në masën 92 % dhe shpenzimet kapitale zënë rreth 49% dhe janë realizuar në masën 52%.

Mosrealizimi në masën 25.7 % e totalit konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të detajuara produktet e planifikuara dhe realizimi përkatës i tyre.

Programi	Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë				08220
Kodi i Produktit	Shpenzimet e Produktit				
	Emri Produktit	PBA Plan 2014	Buxhet Plan 2014	Buxhet/Plan 12-mujori 2014	Buxhet/Fakt 12-mujori 2014
A-00324	Muze Kombetare me standarte dhe shërbime të përmirsuara		100,552	151,000	145,000
B-00324	Infrastruktura arkeologjike, monumentale, peizazhiste në Parqet Arkeologjike		43,462	46,000	43,000
C-00324	Objekte "monument kulture" të konservuara dhe restauruara		237,179	345,817	333,821
D-00324	Aktivitetet e trashëgimisë jomateriale dhe diversitetit kulturor të realizuara		54,441	63,841	60,890
E-00324	Katalogimi i vlerave të trashëgimisë kulturore		7,966	8,500	8,300

MINISTRIA E KULTURËS

	materiale dhe jomateriale				
	Shpronsim			180,000	0
	Totali		443,600	795,158	591,011

Produktet e planifikuara në këtë program në përgjithësi janë realizuar me perjashtim të Shpronsimit.

➤ **“Objekte "monument kulture" te konservuara dhe restauruara**

Ky produkt konsiston në monitorimin, mirmbajtjen, restaurimin, konsolidimin, mbrojtjen e objekteve Monumente Kulture. Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare si dhe Parqet Arkeologjike kryejnë në mënyrë të vazhueshme monitorimin, mirmbajtjen restaurimin, konsolidimin e objekteve Monument Kulture, kështu:

Gjatë vitit 2014, është menaxhuar më me efektivitet fondi aktual art 602 (mallra dhe shërbime) për mirëmbajtjen e monumenteve të Kulturës.

Kështu të gjithë institucioneve ju është dërguar një fond i caktuar me destinacion “Mirëmbajtje Monumentesh”, kjo ka rrezultuar me shumë efektivitet pasi me këtë fond në dispozicion dhe puna konkrete e punonjësve të institucioneve si dhe bashkpunimi me pushtetin vendor, donatorë dhe persona privatë ka bërë që gjatë vitit 2014 janë restauruar, mirmbajtur, konsoliduar, janë kryer pastrime nga vegjetacioni, shpëtim nga gjendja kritike, etj të shumë objekteve Monument Kulture, site arkeologjike, park arkeologjik etj.

Më poshtë po rendisim punën konkrete të kryer gjatë vitit 2014 nga DRKK dhe Parqet Arkeologjike për mirëmbajtjen, restaurimin, konsolidimin, pastrimin nga vegjetacioni, shpëtim nga gjendja kritike, etj. të monumenteve të kulturës.

DRKK - Berat, ka kryer Restaurime e Mirëmbajtje të Monumenteve të Kulturës në Qendrën Historike të Qytetit të Beratit në vlerën 1,764,254 lekë për 16 (gjashtëmbëdhjetë) banesa monument kulture: Banesa e z.Irakli Xhimitikut, Banese e Vallezerise Mile, Banesa e z.Ilia Budes, Banesa e z.Vasil Shyri, Banesa e z. Myfit Mehmeti, Banesa e z. Naun Dyshniku, Banesa e Familjes Haxhistasa, Banesa e z. Lili Simsia, Banesa e z.Luci Zaharia, Banese e Xhoxhi Nacos, Banesa e z.Sofa Tosllukut & Hasan Beqirit, Banesa e z. Sotiraq Mbrices, Banesa e znj. Lefteri Heqimit, Banesa e z. Hermenak Badajani, Banesa e z. Lili Nashos, Zyrat e DRKK Berat. Janë kryer punime mirmbajtje të kalldrëmit para xhamisë mbret, murit rrethues të gurit të Xhamisë Mbret qëndra mesjetare, kalldrëmit lagjja Mangalem, restaurim i murit të gurit midis kullave 1-2 lagjja Kala, etj. Mirëmbajtje dhe pastrim nga vegjetacioni i lartë dhe i ulët në tre lagjet e Qendrës Historike, në qendrën mesjetare dhe në monumentet e kultit të qytetit të Beratit si dhe i Kishës së Shën Kollit në fshatin Perondi, Kuçovë, monument kulture kategoria e parë.

U krye restaurimi i 4 ikonave pjesë e Fondit të ikonave në DRKK-Berat , shtohen 4 ikona të restauruara të gatëshme për ekspozim në Muzeun Onufri ikonat Johan Pagëzori, Fjetja e Shën Marisë, Krishti Pantokrator, Shën Maria me vlerë 493,404 lekë ,

Në bashkëpunim me pronarin është kryer Restaurimi i plotë i “Banesës së Eneleida MAZZOTTA M-133”, Lagjia Mangalem – Berat

DRKK - Durrës, me vlerën 1,300,000 lekë janë kryer punime mirëmbajtje e konsolidimi në muret e Kalasë së Durrësit, Krujës, Elbasanit, Tiranës . Pastrimi nga vegjetacioni në Amfiteatër, në Forumin Bizantin (Rotonda), Murin e Kalasë të qytetit të Durrësit, Termave Antike, i Bazilikes Paleokristiane në Arapaj, Durrës, i Murit të Kalasë në Porto Romanos, në Kalanë e Tiranës, në Kullën e Sahatit në Kavajë, i murit të Kalasë së Elbasanit, i Bazilikes Paleokristiane Elbasan, Kalanë e Zgërdheshit, etj. Gjithashtu janë kryer punime mirëmbajtje në Amfiteatrin Durrës, në Kalanë e Tiranës, në Banesën A. Moisiu si dhe në Muzeun Etnografik Kavajë

DRKK – Gjirokastrë: ka kryer punime mirëmbajtjeje restauruese e konservuese në Kalanë e Gjirokastrës, Sahatit në Kala, Kishën e Shën Mërisë së Labovës, portës hyrëse në banesën Zekate - lagje “Palorto”, banesë në Lagje “11 Janari”-Gjirokastrë, Banesa Skenduli, lagje Palorto - Gjirokastrë, Banesa Zekate, Lagje “Palorto”-Gjirokastrë. Ndërtesë në pazarin karakteristik të Gjirokastrës etj.

DRKK Gjirokastrë në bashfinancim me pronarët e banesave monument kuture apo me CHëB ka kryer mirëmbajtje dhe restaurime në disa objekte: Restaurimi banesa “Korë” , Restaurim i pjesshem i fasades dhe i catise. Restaurimi i portes “Vaso Naka” Restaurimi i plote i catise se portes . Mirëmbajtjeje dyqani i Demir Demiri, u krye restaurimi i catise qe eshte rrezik per kalimtarete. DRKK Gjirokastrë ka kryer Relacione dhe vlerësime risku për banesën Kabili, banesën Cabej, për dyqanin në qafën e Pazarit-Gjirokastrë, Monument Kulture, Kateg. I.

DRKK – Vlorë: Mirëmbajtje dhe pastrim nga vegjetacioni i monumenteve: Kisha e Marmiroit, Kalaja e Kaninës, Kalaja e Porto Palermos, Kalaja e Mavrovës; Restaurim i fasadës së Rugës Justin Godar, restaurimi i Kishës së Shën Spiridhonit në Vuno 4,400,000 leke.

DRKK – Korçë: ka kryer mirëmbajtje dhe ndërhyrje restauruese në fasadën e Muzeut Arkeologjik Korçë, Nderhyrje konservuese në pikturat murale në Kishat e Vithkuqit dhe Boboshticës, në pikturat murale të këtyre kishave. Restaurimi i Kishës së Shën Mëhillit, Vithkuq, Kishës së Shën Marisë në Voskopojë, dhe shtëpinë e Vangjush Mios Korçë, operacion shpëtimi i Kishës së Shën Mëhillit pasi rrezikonte shëmja e çatisë së saj, u krye zëvendësim komplet i çatisë. Nderhyrje në Urën e Golikut, Proptisht, pasi rrezikohej stabiliteti i saj. Nderhyrje të vazhdueshme në ambientet e jashtme të kishave të Vithkuqit dhe Voskopojës si sistetim territori, pastrim nga bimësia etj,. Nderhyrje mirëmbajtjeje dhe pastrimi vegjetacionit dhe bimësisë në Kishat e Voskopojës, Vithkuqit, Bazilikën e Linit, Varret e Selcës si dhe punime mirëmbajtje dhe konservuese në Kishën e Shën Mërisë në Ishullin e Maligradit. Në bashkëfinancim me pronarët Specialistet e D.R.K.K.Korçë kanë nderhyrë në banesën e Pajtimi Halimit dhe kanë kryer punime restauruese si zëvendësimi i catise, zëvendësimi dhe lysterja e kornizave te dritareve, suvatim dhe lysterje e komplet baneses, nderhyrje restauruese ne ambientet e brendshme te baneses.

DRkk – Shkodër me vlerën 2,258,958 lekë ka kryer punime mirëmbajtje konservimi e restaurimi në banesën Oso Kuka (muze vendor), në Kalanë Rozafa është kryer pastrim kalldremi, Pastrimi nga bimesia e ulet dhe e larte, Vendosje e traut metalik ne rrugen e Kalase; Rregullimi i rrjetit elektrik për ndricimin e rrugës së Kalasë; sistemimin e kabinës së biletashitësit; riparimi i

banjove, pastrim vegjetacioni dhe mirëmbajtje e konsolidime në Kala-të Lezhë, Drisht, Grazhdanit Diber, Shurdhah. Pastrim i urave monument në Lezhë, pastrim dhe mirëmbajtje e urës së Mesit, si dhe punime mirëmbajtje në banesën e Filip Çeka, Sadi Muka dhe Xhevat Reishti monument në zonën historike Shkodër dhe Kishën e Shen Venerandes, Pllane, Zejmen Lezhe, Kishën e Shen e Premtes, Balldren Lezhe, Kishën e Shen Sotirit, Kercisht, Maqellare, Diber. Rilevimi dhe kontrolli i zonave Bulqizë, Mat, Mirditë, Tropojë të fortifikimeve

Vig, Marshej dhe Gajtan. Rilevim të kishave në sektorin Dibër, Rilevim i zonës A dhe B, kontroll i përgjithshëm në Lezhë.

Me financim të Komunës Bushat dhe nën mbikqyrjen e Drkk Shkodër është kryer restaurimin e plote të Qeles se Kishes se Kuklit, Bushat, Shkoder me vlerën 8,187,768 lekë, janë kryer ndërhyrje në cati, në ndërkatën e drurit, në dyshemene e katit përdhe, në suvatime të brendshme dhe të jashtme, në grila, dyer dhe dritare etj.

Gjatë vitit 2014 u bë një shtesë fondi prej 57,945,924 lekë për **“Rikonstruksioni i Sheshit “Nënë Tereza”** punime që i dhanë një pamje dhe një vlerë të re sheshit. U kryhen një sërë punimesh në fasadat e objekteve Akademia e Arteve, Universiteti Politeknik-Korpusi, Rektorati, Qendra e Studimeve Albanologjike, Kolonat dhe ambientet përreth tyre. Gjithashtu u bë **Reabilitimi i Pallatit të Kongreseve** në vlerën 38,435,590 lekë. Rikonstruksion në fasadën dhe ambientet e pallatit të Kongreseve

- **“Muze të Rikonstruktuar dhe përmirësuar në infrastrukturë”**

Përmirësimet dhe ndryshimet që ndodhën gjatë vitit 2014 në infrastrukturën muzeore janë një proces zhvillimi i vazhdueshëm, kështu:

Muzeu Arkeologjik, Durrës

Pas punës disa vjeçare për rikonstruksionin e plotë të këtij muzeu, në Mars të vitit 2014 filloi puna për hartimin e projektit të muzealizimit që do të bënte të vizitueshëm katin e parë të muzeut arkeologjik, Durrës. Muzeu i Durrësit është edhe një shembull i bashkëpunimit të pushteti qendror dhe lokal. Me mbështetjen e Bashkisë Durrës, u rehabilitua pjesa e jashtme e Muzeut që do të bëjë të mundur ekspozimin e rreth 60 objekte në pjesën e jashtme të muzeut.

Rihapja e këtij muzeu në shkurt të vitit 2015, do të sjelli në vëmendje jo vetëm të komunitetit të Durrësit, por edhe të vizitoreve dhe studiuesve vlerat që mbart trashëgimia arkeologjike e Durrësit, duke u rikthyer vizitorëve një destinacion të shumëkërkuar të turizmit kulturor.

Muzeu Historik Kombëtar

“Rikonstruksioni i Muzeut Historik Kombëtar” - me vlerë 48,918,936 lekë.

Kjo ishte ndërhyrja e parë e konsiderueshme nga ana e buxhetit të shtetit në Muze. Punimet në ambientet e jashtme dhe në fasadë, Punime në ambientet e brendshme, Punime sistemimi në Atriumin e Muzeut, Punime rikonstruksioni dhe hidroizolim tarrace, u krye vendosja e ashensorit, Sistemi i Monitorimit me Kamera, Sistemi për kontrollin e hyrje daljeve, Vendosja e tabelave informuese, si dhe aksesueshmërinë në të të vizitorëve me kufizime fizike, u vendos rampa për personat me aftësi të kufizuara. Ky rikonstruksion ka përmirësuar ndjeshëm nivelin e sigurisë së Muzeut, ofertën kulturore dhe logjistike të muzeut duke krijuar një platformë të re

dinjitoze për organizimin e eventeve kulturore dhe jo vetëm dhe duke ofruar facilitete normale për cdo institucion kulturor të munguara deri më sot.

Vendosja e biletarisë elektronike: Me qëllim përmirësimin e menaxhimit fiskal të MHK në bashkëpunim me Fondin Shqiptaro Amerikan të Zhvillimit, u instalua biletaria elektronike. Do të vazhdojë procesi dhe në 5 destinacione të tjera të trashëgimisë kulturore.

Godina e re e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar, Korçë.

Gjatë vitit 2014 me një fond prej 23,819,000 lekë financiar nga FZHR dhe nën menaxhimin e bashkisë Korçë vazhdoi puna për ndërtimin e Godinës së re të Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar, Korçë. Projekti synon ta shndërrojë Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar, Korçë në një kartvizitë jo vetëm për qytetin e Korçës, por edhe Shqipërisë, për vizitorët-turistë të huaj, studiues, nxënësit dhe grupmoshat e ndryshme.

Ndërtimi i Godinës së re ku do të qëndrojë Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar, Korçë apo «Qendra për promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore», ka filluar në vitin 2008 me projekt dhe financim të një donacioni Grek, për të mundësuar zhvendosjen e Muzeut të sotëm Kombëtar të Artit Mesjetar, Korçë me të gjithë objektet e ekspozuara, fondin dhe funksionet e saj administrative dhe restauruese në një godinë të re me standarte bashkëkohore për muzeumet e këtij karakteri.

Ndërtimi i godinës parashikohet të përfundojë në prill të vitit 2015 me fondin e parashikuar nga FZHR për vitin 2015. Ndërkohë po përfundon projekti i arredimit të brendshëm. Në Godinën e re të Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar Korçë, numri i objekteve të ekspozuara të rritet në rreth 600 vepra.

Muzeu Kombëtar të Fotografisë “Marubi”

Gjatë vitit 2014 u realizuan këto hapa:

- Në kuadër të projektit “*Muzealizimi dhe Restaurimi i Fototekës Kombëtare “Marubi”*”, si pjesë e projektit ndërrajonal “*Menaxhimi i turizmit të qëndrueshëm të trashëgimisë kulturore të Rajonit të Adriatikut*” i financiar nga fondet IPA-Adriatik të BE, Ministria e Kulturës në bashkëpunim me FSHZH, organizuan në mars të vitit 2014 konkursin për përzgjedhjen e studios-arkitektonike fituese për ndërtimin e Muzeut. Në përfundim të tij juria e Konkursit Ndërkombëtar shpalli fituese Studion Hollandeze të Arkitekturës Casanova & Hernandez. Zbatimi i këtij projekti do të vijojë dhe përgjatë viteve 2015-2016

Qendra Kombëtare e Muzeve Berat

Për vitin 2014 me fonde të buxhetit të shtetit janë realizuar disa nderhyrjeve mirmbajtje në të dy godinat, **Në Muzeun Onufri dhe Muzeun Etnografik**, Këto ndërhyrje kanë përmirësuar jo vetëm kushtet fizike të muzeve por edhe në klimatizimin e brendshëm të mjediseve ku ekspozohen dhe ruhen ikonat. Rehabilitimi i këtij ambjenti ka mundësuar zhvendosjen e fondit të ikonave (700) qëndrojnë të paekspozuara dhe në kushte krejt të papërshtatshme nga DRKK Berat në Muzeun Onufri.

Në Muzeun Skënderbeu dhe Muzeun Etnografik Krujë janë Blerë pajisje kompjuterike dhe vegla pune, në vlerën 94.200 lekë, si dhe është kryer mirmbajtje në vlerën 450.000 lekë, Bojatisja e brendshme e Muzeut Skënderbeu dhe Mirëmbajtje e pjesshme në ambjentet e jashtme të Muzeut Etnografik.

Muzeu i Ri i Përgjimeve Sekrete “Muzeu i Gjetheve”

Me kalimin e godinës së Shërbimeve Sekrete dhe të inventarit të saj nga Ministria e Punëve të Brendshme nën administrimin e Ministrisë së Kulturës, filloi puna për rehabilitimin e godinës dhe ndërtimin e konceptit për muzealizimin e saj. Është bashkëpunuar me ekspertë të huaj dhe vendas për këtë koncept i cili është prezantuar dhe marrë miratimin në parim në Komisionin Shtetëror të Muzeve. Koncept- idea u bë publike përmes një dite të hapur në “Muzeun (e ardhshëm) të Gjetheve” më 24 janar 2015. Aty u lancua për herë të parë dhe ftesa për gjithëpërfshirjen dhe kontributin e qytetarëve me historitë e tyre private që lidhen me këtë “Shtëpi” apo me aktivitetin e saj. Projekti i zbatimit që përfshin rehabilitimin e plotë të godinës, restaurimin dhe muzealizimin e saj, pritet të kapë shifren e 75,000,000leke. Kanë filluar puna lobuese për ngritje të fondeve nga donatorë për t’i bashkuar me fondin aktual (13,500,000leke) fillestar nga buxheti i shtetit për këtë muze.

Ngritja e këtij muzeu unik për nga natyra dhe shkalla e kuriozitetit të vizitorëve-qytetarë vendas dhe të huaj, do të pasurojë ofertën turistike të qytetit të Tiranës me një destinacion të rëndësishëm të memories historike.

Muzeu i Ri i Bashkëjetesës

Qeveria shqiptare mbështeti propozimin dhe ofertën e Komunitetit Mysliman Shqiptar për ngritjen e Muzeut të Bashkëjetesës i cili synon të evidentojë “Bashkëjetesën” si njëtipar unik i popullit shqiptar. Ndërsa komuniteti mysliman financoi hartimin e projektit të muzeut, Ministria e Kulturës ka financuar shpronësimin e pronarëve për vlerën e truallit mbi të cilën do të ndërtohet ky muze. U miratua Projekt- idea për muzeun e Bashkëjetesës.

• “Infrastrukturë e përmirësuar në Parqet Arkeologjike”

Parqet arkeologjike kryejnë në vazhdimësi mirëmbajtjen e territorit si pastrim nga vegjetacioni i lartë dhe i ulët, konsolidim të mureve, paisjen e ambjenteve me tabela informuese etj.

Në **Parkun e i Apollonisë** është kryer pastrim dhe mirëmbajtje e kullës së rrumbullaket ne hyrje te parkut, i sektorit Muri i Amforave, te Nimfeut, Agonotetet Odeoni, banesa me impluvium dhe shtepise me mozaik ,i gjimnazit dhe murit te Temenosit, etj.

Projekti me financim të huaj në sitin arkeologjik të Apolonise “ Restaurimi i Manastirit të Shën Marisë dhe hartimi i Master Planit” do të realizohet në dy vite 2015- 2016.

Parku Bylis punon në vazhdimësi në konsolidimin e mureve, rrugicave, mozaikëve, etj.

Në këto parqe zhvillohen dhe shumë aktivitete të trashëgimisë jomateriale dhe diversitetit kulturor.

Katalogimi i vlerave te trashëgimise kulturore material e jomateriale: “Plotësim i kartelave të Trashëgimisë Kulturore të Paluajtshmë”, janë në vëmendjen e tyre.

Gjatë kësaj periudhe **ZAK Butrint** është përfshirë në disa programe që kanë synuar mirëmbajtjen e monumenteve, kontrollin e vegjetacionit, rritjen e shërbimeve turistike, sigurinë për turistët në vizitën brenda parkut por edhe më gjerë në rrethinat.

“Aktivitete te trashëgimise jomateriale dhe diversitetit kulturor te realizuara”

Gjatë vitit 2014 janë realizuar një sërë aktivitete të planifikuara si dhe disa aktivitete në kuadër të vizitës në muajin shtator të papa Françeskut në Tiranë.

Vazhdon mbështetja e aktiviteteve të realizuara nga shoqata e individë që kanë aplikuar dhe përfituar fondin përkatës të akorduar nga Ministria e Kulturës, në një proces përzgjedhjeje transparent dhe mbi bazë vlerash. Ndër to janë: Festivali i peste i riteve pagane Antigone, Tezgjahistet e reja te Zadrimes, Inventarizimi Digital i Fondit Etnografik Zona para Alpe, Rritja e ndergjegjesimit dhe kultures muzeale ne Berat, Traditat e Vendit tim, E djeshmja në shërbim të së tashmes, Urat e Beratit flasin, Mbrojtja e dialekteve të gjuhës shqipe, Festivali i 11 instrumentistëve të vegjël Fushe Arrez, Trashëgimia kulturore, pasqyre e vlerave Korce, Oda Dibrane, Javet e arkitektures në Tiranë, "E ka kush e ka", Permeti multikulturor CIOFF, java e serenatës korçare, Rikthimi i grupit të Pilurit, Festivali i 6 ndërkombëtar Bylis polifonia, Trashëgimia e usta Laver Bariut, Ripërtëritja e traditës –panair artizanati, 21 maji –Dita Ndërkombëtare e Diversitetit Kulturor, 8 Prilli Mbasdite Kulturore me fëmijë romë, Miqtë e Monumenteve, 18 Maji, Dita Ndërkombëtare e Muzeve, etj.

Në kuadër të 29 shtatorit Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore u zhvilluan një sërë aktivitete në Tiranë dhe rrethe. U zhvillua tryeza e rumbullaket për “Restaurimin dhe Arkeometrinë”, për herë të parë u zhvillua parada dhe festival vallesh popullore, u hap dhe u ndoq me shumë interes ekspozita e veglave popullore tradicionale në MHK, si dhe u realizua ekspozita “Besim” në MHK në kuadër të vizitës së Papës.

Vazhdojnë aktivitetet në mbështetje të nismës së Ministrisë së Kulturës “Miqtë e Monumenteve” e cila konsiston në edukimin e brezit të ri me anë të njohjes, ruajtjes, mbrojtjes, mirëmbajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore shqiptare, përfshirja e shkollave në procesin e mbrojtjes dhe promovimit të monumenteve.

Në këtë kuadër të gjitha DRKK në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore zhvillojnë veprimtari të ndryshme kulturore-artistike, orë mësimore për njohjen me historinë e monumenteve të kulturës si dhe pastrimi dhe mirëmbajtja e këtyre monumenteve nga nxënësit e shkollave që janë pranë këtyre monumenteve, duke realizuar një lloj patronazhi që çdo shkollë do të ketë për një monument. Nisma ka si qëllim :

1) Monumentet mbrohen, kanë përkujdesjen, rijetëzohen dhe promovohen nëpërmjet energjisë krijuese të brezit të ri.

2) Fëmijët dhe të rinjtë edukohen nëpërmjet potencialit që ofron trashëgimia kulturore.

Aktivitetet Trashëgimia 2014

1. Aktivite të zhvilluara nga Drejtoria e Trashëgimisë dhe institucionet në varësi të saj.

Gjatë vitit 2014, Drejtoria e Trashëgimisë kulturore dhe institucionet në varësi të saj, organizuan një sërë aktivitete në funksion të ditëve të shënuara dhe personaliteteve të shquara. Janë organizuar aktivitete më:

8 prill – me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Romëve, u organizua një pasdite kulturore me fëmijë romë,

18 Prilli- Dita Ndërkombëtare e Monumenteve, Nisi rrugëtimin projekti “Miku i Monumentit” që është një prej veprimtarive më të rëndësishme që është zyrtarizuar ndërmjet

Drejtorive Arsimore në rrethe dhe 6 Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare në Durrës, Shkodër, Vlorë, Berat, Gjirokastrë dhe Korçë. Projekti “Miqet e Monumenteve” si synim parësor ka angazhimin e nxënësve në mirëmbajtjen e monumenteve. Mes nxënësve dhe objekteve të trashëgimisë kulturore është synuar krijimi i një lidhjeje organike, ku rol të rëndësishëm, përveç mirëmbajtjes, merr njohja nga afër e monumenteve të kulturës nga nxënësit, vlerësimi i historisë dhe trashëgimisë kulturore të vendit të tyre.

18 Maji: Dita Ndërkombëtare e Muzeve: Me rastin e kësaj dite, përruaa netëorku online i Muzeve Kombëtarë , u organizua ekspozitë me Koleksionistët Privatë.

21Maj: - me rastin e Ditës Botërore të Diversitetit Kulturor, u organizua aktiviteti lancues i nismës “Trego Kulturën Tënde”. Në këtë aktivitet, të zhvilluar në Muzeun Historik Kombëtar, u transmetuan video të regjistruara nga përfaqësues të minoriteteve , të cilat kishin në focus trashëgiminë jomateriale

19 shtator: Konferencë për figurën e Abat Docit: në nderim të kësaj figure të shquar të letrave shqipe, u organizua një konferencë në Qendrën Kulturore të Rrëshenit, ku studiues të ndryshëm hodhën dritë mbi aspekte të jetës dhe veprës së Abat Prend Docit. Aktiviteti u shoqërua me një concert të Ansamblit Popullor të Matit.

29 shtatori: “Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore: dhe “Ditët Evropiane të Trashëgimisë” Në kuadrin e “Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore”, “Ditëve Evropiane të Trashëgimisë” dhe nismës së Ministrisë së Kulturës “Trego Kulturën Tënde” u organizua në Tiranë një aktivitet me tri komponentë:

a. Tryezë e rrumbullakët me temë, “Trashëgimia, Restaurimi, Arkeometria” Kjo tryezë u zhvillua në prani të përfaqësuesve nga institucionet shtetërore të specializuara përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, përfaqësuesve të instituteve shkencore pjesë të Qendrës së Studimeve Albanologjike dhe studiues të shkencave të arkitekturës dhe shkencave të natyrës, përfaqësues të Universitetit të Tiranës dhe Fakulteteve përkatëse. Kjo tryezë, për nga rëndësia që ajo mbarti, ishte një hap i ri drejt fillimit të një bashkëpunimi ndërinstitucional që do të vijoi në të ardhmen. Nga referimet doli në pahë se veprimtaria e tyre shkencore rezulton se ka kontribuar dhe është një vlerë e shtuar, në ruajtjen dhe konservimin e dëshmimeve tona të trashëgimisë kulturore. Referuesit me prezantimet tyre profesionale përmbushën një nga aktivitetet e munguara deri tani. Ky aktivitet pati vëmendjen dhe u pasqyrua në disa media.

b. Parada e Valleve Popullore dhe koncerti I Valleve popullore, concert i cili u zhvillua në sheshin Nënë Tereza, me pjesëmarrjen e ansambleve të këngëve dhe valleve popullore të gjithë vendit.

c. Ekspozita e instrumentave muzikorë tradicionalë të zhvilluar në MHK, në hollin e të cilit u ekspozuan për disa ditë instrumenta të vjetër muzikorë, pjesë e koleksionit privat të studiuesit Mark Marku. Ekspozita u shoqërua me një performancë vallesh dhe të grupit ‘Arketip’ .

d. Aktivitetet e zhvilluara nga DRKK –të në kuadër të Ditës Kombëtare të Trashëgimisë.

DRKK SHKODËR, Në Shkodër pati disa aktivitete të ndryshme , në **Galerinë e Arteve**, Ekspozita "Monumente, Pejsazhi dhe DRKK Shkodër". Në këtë ekspozitë u paraqitën fotografi, postera të përmasave të ndryshme të trashëgimisë kulturore materiale, me monumente e pejsazhe, si dhe punën e bërë nga DRKK e Shkodrës, u botua "Libri Prezantues" si dhe një fletëpalosje e DRKK Shkodër. Në **Kalanë e Shkodrës** pati guida prezantuese dhe shpjegime në muzeun e saj si aktivitete ndihmëse, shoqëruar me videoprezantim.

DRKK DURRËS në bashkëpunim me Bashkinë Durrës dhe DAR, Durrës, si dhe me faktorë të tjerë lokale të interesuara për trashëgiminë kulturore, një aktivitet në Qendrën Historike të Durrësit, me temë rëndësia e njohjes dhe mbrojtjes së monumenteve të kulturës në tërësi dhe qytetit në vecanti.

Nxënësit e shkollave të cilët kanë birësuar monumente të trashëgimisë kulturore në kuadër të nismës miqtë e monumenteve, u vendosën pranë tyre (**Tek Amfiteatri**, tek **muret e kalasë**, **Tek muzeu "A. Moisiu"**, **Tek Hamami**, **Tek Rotonda**,)duke performuar dhe krijuar një atmosferë që të rikujton historinë e këtyre monumenteve. Qytetarët të ardhur enkas për këtë ditë, bënë një rrugëtim të shkurtër nëpër Qendrën Historike të Qytetit, ku ndjenë nga afër atmosferën festive të këtyre aktiviteteve.

DRKK BERAT u zhvillua një Lektorium mbi fazat e restaurimit të një vepre arti. U shpërndanë fletëpalosje të ndryshshme informuese, mbi veprat e artit të restauruara nga specialistët e DRKK. shfaqje video për vlerat historiko - kulturore të këtij qyteti. Si dhe u organizuan një sërë aktivitetesh me "Miqtë e Monumenteve" në disa prej monumenteve të Qendrës Historike.

DRKK VLORE Në bashkëpunim me Qarkun Vlorë në ditën Ditën e Trashëgimisë Kulturore dhe diteve Evropiane të monumenteve, realizoi dhe shpërndau postera dhe fletëpalosje promovuese mbi vlerat arkeologjike të këtij qyteti. Pati një ekspozitë fotografike me temë, "Vlera monumentale në vazhdimësi të Qarkut Vlorë". Në kuadër të projektit "Miqtë e Monumentit" në dt.26.09.2014, u organizuan takime informuese me nxënësit e shkollave pranë monumenteve të kulturës si, në Qytetin Antik të Orikut, në Kalanë e Himarës, në Kalanë e Kaninës, Manastirin e Zvërnecit dhe Sinagogën në Sarandë. Në dt. 27.09.2014 u organizuan ekspedita njohëse dhe përgatitja e albumeve fotografikë për shpellat, urat dhe çezmat antike.

Gjithashtu në dt. 27.09.2014, në bashkëpunim me Shkollën Artistike, në kuadër të projektit "Miqtë e Monumentit" u organizua një ekspozitë me piktura të veshjeve tradicionale të zonës. Në datat 24 - 29 shtator 2014 u organizua vizita në Muzeun e Pavarësisë, Muzeun Historik dhe Muzeun Etnografik të qytetit.

DRKK KORÇË, organizoi një simpozium për prezantimin e siteve arkeologjike dhe vlerave materiale të monumenteve të kulturës, në Bazilikën e Linit, në bashkëpunim me shkollën e fshatit Lin, u zhvillua një aktivitet në kuadër të projektit "Miqtë e Monumentit".

DRKK GJIROKASTËR, në sheshin "Çerçiz Topulli", u hap një Ekspozitë fotografike me temë Gjirokastra si pjesë e trashëgimisë kulturore botërore si dhe u organizuan një sërë veprimtarish të ndryshme njohëse kulturore, me pjesëmarrjen e disa shkollave, pranë monumenteve kulturore të qendrës historike të qytetit.

Sektorët Përmet, Tepelenë kanë zhvilluar aktivitete pranë monumenteve të kulturës nga grupi "Miku i Monumentit" me fotografi të monumenteve të kulturës të rrethit të Përmetit. Në bashkëpunim me Bashkinë e qytetit, u bë një Pastrim i monumentin natyror të quajtur "Guri i qytetit". Në Tepelenë u zhvilluan disa vizita, biseda, fushata sensibilizuese me shkollave të rrethi

dhe banorët e qendrave të banuara pranë monumenteve të kulturës të këtij qyteti si, Kalaja e Ali Pashë Tepelenës etj

PARKU ARKEOLOGJIK APOLLONI u zhvillua aktiviteti "Apolonia - Thesari ynë i përbashkët", ku protagonistë ishin pjestarët e rrethit të historianeve dhe arkeologeve të vegjël të shkollës "Miti Stroni". Ky aktivitet ishte vazhdim i veprimtarive edukative dhe sensibilizuese që Zyra e Parkut Arkeologjik të Apolonisë organizon në vazhdimësi me nxënësit e shkollës 9-vjeçare të fshatit Pojan.

Nxënësit u njohën me zhvillimet e reja që pritet të ndodhin në Parkun e Apolonisë dhe që do të sjellin një impakt të rëndësishëm në jetën e komunitetit që jeton brenda dhe përreth Parkut.

Nën drejtimin e arkeologëve shqiptarë dhe gjermanë, historianët dhe arkeologët e vegjël nga Pojani "prekën" nga afër gërmimet arkeologjike që ekspedita e përbashkët shqiptaro-gjermane po zhvillon aktualisht në sektorin e Teatrit antik.

Këto veprime tërhoqën vemëndjen e turistëve që gjendeshin në Apoloni. Ata përfituan edhe shpjegime shtesë në lidhje me ndryshimet në të ardhmen e afërt të Parkut Apolonia, që falë financimit nga BE dhe mbështetjes së Ministrisë së Kulturës pritet të ndodhin shumë shpejt.

Gërmimet Shqiptaro-Gjermane i vizitoi edhe ambasadori gjerman i akredituar në Tiranë së bashku me një grup gazetarësh.

1.7 "Narracioni i legjendave përmes novelave grafike". Aktiviteti u organizua në formën e konkursit ku moren pjesë studentë, nxënës, artistë profesionistë e amatorë. Punimet e konkurrenteve u perzgjodhën nga një juri me eksperte të huaj dhe u prezantuan në ekspozitën që u hap në Ministrinë e Kulturës më 14 nëntor. Aktiviteti u kurorëzua me dhënien e 3 çmimeve të para fitueseve, shpërndarjen e katalogëve me punimet e konkuruesve dhe një bisedë me ekspertet për problematiken e novelave grafike në vendin tone. Qëllimi i aktivitetit ishte nxitja e edukimit artistik e gjuhësor të brezit të ri përmes vlerave të trashëgimisë kulturore, materiale (konteksti) dhe jomateriale (shprehja), të aplikuara në gjininë e novelave grafike. Aktiviteti u ndoq me shumë interes nga një publik i gjërë.

1.8 Konferencë për Edith Durham : më rastin e 70 vjetorit të vdekjes së studiueses britanike Edith Durham, u zhvillua në MK një konferencë, ku studiues të ndryshëm hodhën dritë mbi aspekte të jetës dhe veprës së kësaj figure.

1.9 Festivali i Këngëve dhe Valleve Lushnje organizuar nga Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike

1.10 Festivali i Këngës Qytetare, Elbasan, organizuar nga Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike

1.11 : Tryezë e rrumbullakët "Edukimi përmes brezave" organizuar nga Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike

Gjatë vitit 2014 MK, përmes thirrjes publike për projekte, DTK mbështeti 19 aplikime për aktivitete. Një përshkrim të aktiviteteve dhe shumave të financimit, po e rendisim më poshtë.

Gjatë vitit 2014 MK, përmes thirrjes publike për projekte, DTK mbështeti 19 aplikime për aktivitete. Një përshkrim të aktiviteteve dhe shumave të financimit, po e rendisim më poshtë.

Projekti: "Inventarizim Dixhital i Fondit Etnografik Zona Para Alpe", paraqitur nga: Instituti Shqiptar i Shkencave. Projekti i propozuar ishte me interes dhe prioritet për Ministrinë e Kulturës, ndaj u mbështet me 520.000 lekë. Në periudhën prill - dhjetor 2014, u

bënë kërkime për fondin etnografik në fshatrat Iballë, Mërtur Guri dhe Arsmiliska të rrethit të Pukës, duke evidentuar të dhënat teknike të objekteve, me produkt kartelat e plotësuara sipas modelit të QKIPK. Sugjerojmë që nëse ka bashkëpunim tjetër, shoqata aplikante duhet të nënshkruajë paraprakisht marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore, lidhur me kartelizimin, detajet e përshkrimit dhe specifikimet teknike të dixhitalizimit të elementeve të trashëgimisë kulturore.

Projekti: “ Rrënjët e kaçkavallit, paraqitur nga: Qendra për zhvillim dhe Demokratizim të Institucioneve Ky projekt, mbështetur nga MK në shumën 506.200 lekë, ishte i pari lidhur me trashëgiminë kulinare, të përfshirë në atë jomateriale. U zhvilluan hulumtime e kërkime në Shqipëri për origjinën e dihebërjes së kaçkavallit, me produkt 3 artikuj informues në shqip dhe anglisht, si dhe botimi elektronik online.

Projekti: “ Rikthim pas 18 vjetësh i grupit të Pilurit, Antologjia e re: “Këngët e Atdheut tim”, paraqitur nga: Shoqata Publike Në kuadrin e këtij projekti, të mbështetur në masën 600.000 lekë, u realizuan botimet e “Antologjisë” dhe “Trilogjisë” me tekste këngësh polifonike të autorit Lefter Cipa. Këto dy botime do të kontribuojnë në risjelljen në vëmendjen e studiuesve dhe artdashësve të vlerave të isopolifonisë, si dhe dokumentimin dhe përhapjen e teksteve të këngëve isopolifonike, të shkruara nga ky autor i mirënjohur popullor dhe të interpretuara nga grupi i Pilurit.

Projekti : “Tezgjahistet e reja të Zadrimes”, shoqata “Kultura zadrimore”, Shkodër

Në kuadrin e këtij projekti, të zhvilluar në fshatin Guri i Zi, Shkodër, në periudhën maj-qershor 2014 u zhvilluan disa aktivitete, Realizimi i një kursi trainimi tridhjetëditor me vajza të reja për të mësuar profesionin e artizanit dhe nxitur dashurinë ndaj këtij zanati. Si pasojë e realizimit të trainimit është arritur aftësimi i vajzave për të mësuar profesionin e artizanes. Ato kanë arritur të nxjerrin nga duart e tyre produkte cilësore si shalle, mbulesa tavolinash, peceta, riza, etj. Hapja e një panairi të prodhimeve artizanale në datën 30 qershor në qendër të komunës. Zhvillimi i një konkursi për veprimtarinë kreative dhe prodhimet tradicionale artistike të artizanëve të zonës. Një koncert artistik përmbyllës i projektit.

Ky projekt, i cili u mbështet nga MK në shumën 375.000 lekë, shërbeu për promovimin e vlerave të trashëgimisë kombëtare jomateriale, si dhe nxitjen e turizmit në zonën e Zadrimes.

Projekti: “ Rritje e ndërgjegjësimit dhe e kulturës muzeale në Berat”, paraqitur nga: Universiteti i Nju Jorkut në Tiranë

Nëpërmjet këtij projekti në fushën e edukimit me vlerat e trashëgimisë, mbështetur nga MK në shumën 272.500 lekë, është synuar rritja e ndërgjegjësimit për vlerat kulturore muzeale në qytetin e Beratit, përmes një modeli të ri menaxhues të muzeve.

Nisma të tilla kanë rëndësi në drejtim të rritjes së vizitueshmërisë së muzeve, transmetimit të kulturës muzeale në brezin e ri, si dhe shfrytëzimit të ekspozitave tematike, për tërheqjen e vëmendjes drejt muzeve.

Projekti: “Festivali i 5-të i Riteve Pagane dhe Lojrave Popullore - Antigone 2014”, paraqitur nga: Qendra Kulturore Mediatike Antigonea.

Veprimtaria kulturore “Festivali i V-të i riteve pagane dhe lojrave popullore - Antigone 2014“, u zhvillua nga “Qendra Kulturore Mediatike Antigonea”, në funksion të promovimit të vlerave të trashëgimisë kulturore jomateriale. Kjo veprimtari u organizua më 31 maj 2014, në mjediset e Parkut Arkeologjik Antigone, në Gjirokastrë. Në këtë veprimtari morën pjesë 18 grupe interpretuese të riteve pagane dhe lojrave popullore shqiptare, si dhe individë e studiues të trashëgimisë kulturore, folkloristë, e albanologë. Vlerat dhe rëndësia e këtij festivali u dëshmuar

si në larminë e riteve dhe lojnave, te sjella në skenë nga artistë popullorë të talentuar, ashtu dhe në rijetëzimin e tyre përmes interpretimit nga të rinjtë. Ky projekt u mbështet nga MK në shumën 408.000 lekë.

Projekti: “Traditat e vendit tim”, paraqitur nga Fondacioni: “Tradita popullore”

Fondacioni “Tradita popullore”, në bashkëpunim me komunat Prezë dhe Kashar më datë 20 maj 2014, zhvilloi në Kalanë e Prezës veprimtarinë “Traditat e vendit tim”, e organizuar si ndërthurje midis trashëgimisë materiale dhe jomateriale, me një panair artizanati dhe të kulinarisë së zonës, sfilatës me kostume nga të gjithë trevat shqiptare, performancave folklorike dhe sfondit me dekorin e mikromjedisin tradicional. Ky projekt u mbështet në shumën 310.000 lekë.

Projekti: “E djeshmja në shërbim të së tashmes – Valorizimi i trashëgimisë materiale të diktaturës në Shqipëri”, paraqitur nga: Fondacioni EDS Projekti “E djeshmja në shërbim të së tashmes”, i realizuar nga fondacioni “EDS”, konsistonte në krijimin e një katalogu online, me qëllim valorizimin e trashëgimisë materiale të krijuar në periudhën e diktaturës. Në periudhën maj – dhjetor 2014, u evidentuan munumentet në zonat kryesore të Shqipërisë dhe më pas u realizuan skedat e katalogut dhe informatizimi i tyre, për t’u hedhur në faqen Eëiki të Ministrisë së Kulturës. Projekti u mbështet nga MK në shumën 669.230 lekë.

Projekti : “Urat e Beratit Flasin”, paraqitur nga “Forumi i Pavarur i Gruas” Në kuadër të projektit ndërkombëtar “Urat e Ballkanit flasin”, Forumi i Pavarur i Gruas Shqiptare (FPGSH), në bashkëpunim me UNESCO-n, Fondacionin “Balkanika”, Bashkinë e Beratit dhe partnerë të tjerë nga rajoni, organizoi në Berat më 29-30 Mars 2014, projektin: “Urat e Beratit flasin” duke e konsideruar kulturën si një urë drejt zhvillimit. Projekti u mbështet nga MK në shumën 319.000 lekë. Ky aktivitet ishte i treti në kuadër të projektit “Urat e Ballkanit flasin”, projekt i zhvilluar në vitet 2013 - 2014 në të gjithë Evropën Juglindore, për të nxjerrë në pah urat, si simbole të fuqishme të komunikimit dhe mirëkuptimit mes popujve. Projekti zhvilloi disa aktivitete si:

-Tryeza e rrumbullakët me titull: “**Krijimi i rrjetit të qyteteve pjesëmarrës në projektin “Urat e Ballkanit Flasin”**”.

- Inaugurimi i ekspozitës së pikturës “Artistët e Ballkanit pikturojnë Urën e Goricës”, në Galerinë e Arteve “Edëard Lear”. Në këtë ekspozitë morën pjesë piktorë nga vende të ndryshme të Ballkanit, të cilët i krijuan veprat e tyre në ajër të hapur tek Ura e Goricës, përgjatë dy ditëve 29 -30 Mars dhe veprat e tyre ia dhuruan qytetit të Beratit.

- Koncert në urën e Goricës , me pjesëmarrjen e grupeve të valleve folklorike nga Shqipëria dhe Bullgaria.

- Panair i artizanëve nga Berati dhe Gjirokastra.

- Foto-ekspozitë “Murmurima e ujërave”.

- Spektakël 3D animacion mbi Urën e Goricës.

Ky projekt arriti të nxisë krijimtarinë, dialogun dhe shkëmbimet kulturore, për të frymëzuar qasje inovative dhe krijuese për ruajtjen e trashëgimisë dhe kulturës, kundrejt politikave të zhvillimit të qendrueshëm. Ai realizoi synimin kryesor, për të siguruar hapësira për bashkëpunim kulturor ndërrajonal dhe për të nxitur shkëmbimet ndërmjet artistëve, profesionistëve të kulturës, urbanistëve, pushtetit vendor e shoqërisë civile.

Projekti: “Mbrotjtja e dialekteve të gjuhës shqipe në kushtet e globalizimit”, paraqitur nga: “Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim” (RIAS)

Projekti “Mbrotjtja e dialekteve të gjuhës shqipe në kushtet e globalizimit” i shoqatës RIAS kishte në fokus gjuhën e format e saj, duke u përputhur kështu me prioritetet aktuale të MK.

Në periudhën maj-qershor 2014, u zhvilluan disa aktivitete, ku më kryesori ishte organizimi i tre workshop-eve në Tiranë, Korçë e Shkodër, ku morën pjesë si lektorë, personalitete të mirënjohura të linguistikës shqiptare, si Ak. Kolec Topalli e Artan Fuga, Mimoza Kore, Linda Mëniku, Ali Jashari (Korçë), Anisa Kosteri (Shkodër) apo dhe redaktorë e gazetarë si Monika Stafa e Alda Bardhyli, duke dëshmuar qasje të ndryshme ndaj dialekteve të shqipes.

Pas ligjëratave u diskutua nga të pranishmit, të cilët ishin të rinj universitarë, për rëndësinë e dialekteve dhe mbrojtjes së tyre në kushtet bashkëkohore.

Ligjëratat e diskutimet u përmbledhën në një botim, për tu promovuar në disa gjimnaze të Tiranës. Përveç kësaj u organizua dhe aktiviteti interesant i FanBook-ut, që konsistonte në diskutimin e një libri të botuar në dialekt.

Ky projekt nga një organizatë rinore me përvojë, u paraqit i organizuar dhe koordinuar mirë, duke sjellë prurje e qëndrime interesante në drejtim të njohjes së gjuhës shqipe dhe dialekteve të saj nga brezi i ri. Përfshirja dhe konsultimi me ekspertë të njohur të fushës i dha projektit efikasitet dhe besueshmëri. Ky projekt u mbështet nga MK në shumën 500.000 lekë.

Projekti: “Festivali i 11-të mbarëkombëtar i instrumentistëve të vegjël popullorë” Fushë Arrëz, maj 2014, paraqitur nga “Shoqata ekoturistike, Pukë”

Në Festivalin e 11-të mbarëkombëtar të instrumentistëve të vegjël popullorë, që u zhvillua në Fushë Arrëz, në datat 23 – 25 maj 2014, morën pjesë 19 grupe, të cilët paraqitën performancat e tyre artistike dhe vlerat etno-kulturore të trevave shqiptare tek brezi i ri, për edukimin e tyre me trashëgiminë tonë kulturore jomateriale.

Kjo veprimtari kontribuoi në gjallërimin e jetës kulturore dhe sociale në Fushë-Arrëz. Problem paraqiti mungesa e grupeve nga Jugu. “Shoqata ekoturistike, Pukë”, për këtë projekt është mbështetur nga MK, në shumën 460.000 lekë.

Projekti: “Trashëgimia kulturore, pasqyrë e vlerave dhe nivelit kulturor të rajonit Në kuadër të projektit, Shoqata e Grave Sociale u financua nga Ministria e Kulturës për të mbështetur disa zëra që kishin të bënin me organizimin e dy panairove të artizanatit përkatësisht në Tushemisht dhe Voskopojë si dhe punën e dy inkubatorëve artizanalë ekzistues. Gjatë kësaj periudhe kohore dy inkubatorët artizanalë, në fshatrat turistike të Tushemishtit dhe Voskopojës kanë funksionuar dhe kanë shërbyer si pika referuese të trashëgimisë dhe identitetit kulturor të zonave përkatëse, për turistët vendas dhe të huaj të cilët kanë vizituar këta dy fshatra. Pranë këtyre dy inkubatorëve, të njohur ndryshe si “Shtëpia e Duarve të Arta”, vizitorët kanë patur mundësinë të njihen me punimet artizanale tradicionale të zonave, suvenirët karakteristike të fshatrave, si dhe ushqimet karakteristike të zonës së Tushemishtit dhe Voskopojës. Gjithashtu në këto dy shtëpi, turistët janë informuar mbi pikat turistike të zonës, hotelerinë, restorantet dhe baret e argëtimit në këto zona. *Organizimi i dy panairove me produkte artizanale.* 2 panairët e produkteve artizanale, specifikisht më datë 24 Qershor 2014 në Voskopojë dhe më datat 23-24 Gusht 2014 në Tushemisht të Komunës Buçimas. Qëllimi i organizimit të panairove ishte jo vetëm promovimi i produkteve artizanale të prodhura në inkubatorë, por mbi të gjitha rritja e vizibilitetit të trashëgimisë kulturore të këtyre zonave. Panairët krijuan një mundësi për rreth 40 artizane për të promovuar produktet e tyre. Panairët shërbyen si një mundësi shumë e mirë për gjenerimin e të ardhurave dhe shkëmbim eksperiencash midis artizaneve të zonave të ndryshme. Vlen për të theksuar angazhimi dhe mbështetja e këtyre dy komunave përkatëse për organizimin e panairove.

Gjithashtu takime të shumta u organizuan dhe me bizneset vendase dhe artizanë të zonave për të siguruar pjesëmarrjen e tyre në panairë.

Në kuadër të rritjes së vizibilitetit të aktivitetit u bashkëpunua ngushtë dhe me mediat lokale.

Projekti: “ODA DIBRANE, edicioni i 20-të”, paraqitur nga Veli Vranici, Qendra Kulturore, Peshkopi. Në datat 23 – 26 tetor 2014 u zhvillua në Peshkopi edicioni jubilar i 20-të i festivalit “ODA DIBRANE”, i cili është kthyer tashmë në një aktivitet të traditës, në përputhje me prioritetet e Ministrisë së Kulturës në fushën e trashëgimisë jomateriale. Kjo veprimtari u organizua nga Qendra Kulturore, Peshkopi, Bashkia Peshkopi, etj. dhe u mbështet nga MK në shumën 450.000 lekë. Në të morën pjesë ansamble e grupe të njohura nga mbarë trevat shqiptare, duke promovuar vlerat artistike të trashëgimisë sonë. Për herë të parë, një shfaqje e grupeve pjesëmarrëse në këtë festival, u zhvillua edhe në Dibrën e Madhe, duke kontribuar në bashkëpunimin ndërkufitar në fushën e trashëgimisë kulturore. Festivali gjallëroi më tej jetën kulturore të qyteteve të Peshkopisë dhe Dibrës së Madhe.

Projekti: “Festivali ndërkombëtar - Përmeti multikulturor 2014 (minoritete dhe etni) ”, paraqitur nga: Seksioni Kombëtar Shqiptar i CIOF “Seksioni Kombëtar Shqiptar i CIOF” ka zhvilluar projektin “*Festivali ndërkombëtar - Përmeti multikulturor 2014 (minoritete dhe etni)*”, në qytetin e Përmetit, në datat 21-23 qershor 2014. “Përmeti multikulturor” është një aktivitet që ka krijuar tashmë një traditë 10 vjecare dhe sjell në skenë trashëgiminë jomateriale të minoriteteve. Ky projekt është në përputhje me prioritetin e Ministrisë së Kulturës në fushën e trashëgimisë jomateriale.

Projekti: “Trashëgimia shpirtërore e Usta Laver Bariut në CD”, paraqitur nga Vasil Tole Projekti “*Trashëgimia shpirtërore e Usta Laver Bariut në CD*”, u kurorëzua në 14 maj në sheshin kryesor të qytetit të Përmetit me një koncert të sazeve të zonës së jugut. Ky projekt i ndërmarrë nga studiuesi Vasil Tole, konsistoi në botimin e një CD-je me repertorin e njërit prej mjeshtërave të kabasë, Laver Bariut, dhe kontribui në pasurimin e fondit dixhital të muzikës shqiptare. MK e mbështeti këtë projekt në shumën 300.000 lekë.

Projekti: “Festivali i 6 Ndërkombëtar i Polifonisë – Bylispolifonia 2014”, paraqitur nga Shoqata “Polifonia shqiptare”. Festivali i 6 Ndërkombëtar i Polifonisë “*Bylispolifonia 2014*”, u zhvillua në Parkun Antik Bylis, në datat 5,6 korrik 2014. Në këtë festival, i cili tashmë ka krijuar një traditë të mirë dhe ka kontribuar në kultivimin e këngës polifonike, morën pjesë rreth 20 grupe folklorike. Rëndësia e tij qëndron edhe në gjallërimin e jetës kulturore të kësaj treve të Shqipërisë. Ndër performuesit kishte mjaft të rinj debutues, gjë e cila shërben në transmetimin e thesareve kulturore nga një brez në tjetrin. Projekti u mbështet nga MK në shumën 310.000 lekë.

Projekti: “Java e serenatës korçare 2014”, paraqitur nga fondacioni “E shkuara për të ardhmen” Fondacioni “*E shkuara për të ardhmen*” e zhvilloi këtë projekt të mbështetur nga MK në shumën 305.000 lekë, në periudhën qershor - korrik 2014. Ky aktivitet i traditës konsistonte në evidentimin, përzgjedhjen e përgatitjen për interpretim të prurjeve të reja të serenatës korçare, duke kulmuar me një seri koncertesh në Korçë, Voskopojë, Tushemisht, Manastir e Leskovac (Serbi), si dhe përgatitjen e një CD me materialet më të mira. Përveç rëndësisë për promovimin e këtij zhanri të trashëgimisë kulturore dhe përcjelljes tek brezat e rinj të serenatës, si fenomen kulturor dhe pasuri shpirtërore, projekti shërbeu dhe në promovimin e vlerave shqiptare përtej kufijve shtetërorë.

Projekti: “Ripërtëritja e traditës”, paraqitur nga Fondacioni “Gjirokastra” Projekti “RIPËRTËRITJA E TRADITËS” (Panairi i 8-të Kombëtar i Artizanatit dhe Trashëgimisë “*Gjirokastra 2014*”) i realizuar nga Fondacioni “Gjirokastra” (i njohur edhe me emrin Organizata për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës – GCDO) u zhvillua në datat 28-30 shtator 2014 në Gjirokastrë. Panairi këtë vit, në edicionin e tij të 8-të, shërbeu ndër të tjera si një

aktivitet promovues për punimin dhe riprodhimin e kostumeve popullore. Në këtë kuadër, tema kryesore e këtij viti qenë kostumet popullore, mirëmbajtja dhe zhvillimi i tyre në ditët e sotme. Pikërisht në ditët e Panairit organizua dhe konkursi “Punimet më të mira artizanale të frymëzuara nga motivet e kostumeve popullore tradicionale”. Fituesit e konkursit u zgjodhën nga një juri e specializuar dhe u shpallën në natën e dytë të Panairit në një mbrëmje (“Vallëzon Shqipëria”) me kostume popullore, ku u shpalosën edhe vlerat më të mira në krijimet dhe prodhimin e kostumeve nga gjithë trevat shqiptare. Një tryezë e rrumbullakët u realizua në ditët e Panairit për problematikën së ruajtjes dhe zhvillimit të vlerave që paraqesin kostumet popullore. Në të morën pjesë përfaqësues nga MK, institucionet e kulturës dhe trashëgimisë në Gjirokastër, Bashkia e qytetit; artizanë dhe artistë pjesëmarrës në Panair. etj. Dy tryeza të tjera në ditët e Panairit iu kushtuan njëra Trashëgimisë dhe Punësimit dhe tjetra Trashëgimisë Natyrore dhe Turizmit. U financua nga MK në shumën 243.000 lekë.

Projekti: “Javët e Arkitekturës në Tiranë”, paraqitur nga Universiteti Polis Në kuadër të projektit, “Java e Arkitektures” realizuar nga Universiteti Polis, Ministria e Kulturës financoi zërat “dhënie cmimesh” për këtë aktivitet. Ky aktivitet ndërkombëtar, u realizua në datat 15 shtator deri më 12 tetor, duke organizuar disa evente të rëndësishme përgjatë tij si psh: diskutime Publike “Albania unfinished”, ëorkshope si : “Tirana interrupted event”, Complexity as self regulation”, “Deep in the skin event” etj Cmimet iu dhane pesë pjesëmarrësve të huaj të cilët konkurruan për konkursin “Arkitektura e humbur- duke përfytyruar sheshet e reja të qytetit”. Konkursi kishte si qëllim hapjen e ideve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për objektin “Qendra Ndërkombëtare e Kulturës” (ish Piramida) si dhe të sheshit të këtij objekti. Në konkurs morën pjesë rreth 30 grupe pjesëmarrëse të cilat paraqitën projektidetë e tyre. Mga MK janë mbështetur çmimet fituese në shumën 300.000 lekë.

Sensibilizimi i komunitetit dhe nxensave të shkollave për tu bërë më të vëtedijshëm për njohjen e pasuritë e përbashkëta të monumenteve të kulturës që ndodhen në territoret e tyre.

Aktivizimi i shumë aktoreve nëpërmjet aktiviteteve kulturore artistike në objektet e monumenteve të kulturës.

➤ **Katalogimi i vlerave të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale**

Në kuadër të krijimit të Fondit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Ministria e Kulturës nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore vazhdon procesin e katalogimit të objekteve të trashëgimisë kulturore në fushat Arkeologjisë, Artit pamor, Etnografisë, Arkitekturës, etj. për vitin 2014 janë regjistruar:

Kartela të reja në Katalogun “**ONUFRI**”, ku janë kataloguar objekte që i përkasin kryesisht institucioneve shtetërore si Muzeu Historik Pogradec, Muzeut Arkeologjik Butrint, Muzeu Arkeologjik Tiranë, Muzeu Arkeologjik Durrës, Muzeu Etnografik Berat. Kartela të reja në Katalogun “**MARO KONDI**”, janë regjistruar kartela të reja me të gjithë të dhënat përkatëse të personave privatë si dhe janë bërë të gjitha transaksionet për objektet që kanë dalë jashtë vendit. Kartela të reja në Katalogun “**SOTIRI**”, janë regjistruar të gjithë objektet me të dhënat përkatëse dhe ka përfunduar si proces. Projekti për pasurinë trashëgimi: “Foto ekspozitë, Fototeka Sotiri, Korçë” u finalizua me ekspozitën në Korçë në muajin prill 2014. **QKIPK** mban kontakte të bvazhdueshme me të gjithë muzetë e rretheve për inventarizimin dhe katalogimin e

objekteve që nuk janë regjistruar në QKIPK, si dhe paisja me foto cilësore të objekteve që janë të regjistruara. Gjithashtu janë bërë Regjistrim të dhënash (pasaporta) dhe shitesave të viteve të fundit në Muzeu Historik Pogradec, Muzeut Arkeologjik Butrint, Muzeu Arkeologjik Tiranë, Muzeu Arkeologjik Durrës, Muzeu Etnografik Berat. Gjithashtu në Qendrën Kombetare të Inventarizimit të Pasurive Kulturoregjatë vitit 2014 u bënë disa përmirësime në programet ekzistues, rrjetin e serverave si dhe në blerjen e paisjeve të reja.

3. Programi: “ ARTI DHE KULTURA”

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 12- mujori 2014		Realizimi 12- mujori 2014		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	519,533	54.1%	507,659	55.5%	97.7%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	280,561	29.2%	253,416	27.7%	90.3%
12	01110	231	Kapitale	159,372	16.6%	153,072	16.7%	96%
			TOTALI	959,466	100%	914,146	100%	95.3%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 95%. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 54% të totalit dhe janë realizuar në masën 98%. Shpenzimet korrente zënë rreth 29% të totalit dhe janë realizuar në masën 90%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 17% dhe janë realizuar në masën 96%. Mosrealizimi i fondeve në masën 4.7 % konstatohet kryesisht në shpenzimet korrente.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të detajuara produktet e planifikuara dhe realizimi përkatës i tyre.

në (000) lekë

Programi	Arti dhe Kultura					08230
Kodi i Produktit	Shpenzimet e Produktit					
	Emri Produktit	PBA Plan 2014	Buxhet Plan 2014	Buxhet/Plan 12-mujori 2014	Buxhet/Fakt 12-mujori 2014	
A-00325	Veprimtari te realizuara ne institucionet e art kultures		628,966	754,612	714,024	
B-00325	Veprimtari te realizuara me fondet e programit art kultures		189,291	189,291	184,559	

MINISTRIA E KULTURËS

C-00325	Perfaqesimi ne programe dhe evenimente nderkombetare		15,563	15,563	15,563
	Totali		833,820	959,466	914,146

Për realizimin e shpenzimeve buxhetore si dhe argumentimeve përkatëse, për periudhën Janar – Dhjetor 2014, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik për Artin dhe Kulturën, në zbatim të politikave qeverisëse dhe Programit Art-Kulturë 2013-2017 në MK, ka realizuar me sukses pothuajse çdo objektiv të parashikuar për vitin kalendarik 2014. Në vijim dhe të raporteve të mëparshme, kjo Drejtori ka përforcuar bashkëpunimin me institucionet qendrore të artit dhe kulturës në vend, duke rritur standartet administrative në art dhe kulturë, duke rritur cilësinë artistike, duke garantuar promovimin e artistëve shqiptar elitar në skenat botërore.

Një hap i rëndësishëm është hedhur në reformën e domosdoshme, me krijimin e strukturave të reja të krijuara në aparat MK dhe pranë institucioneve të vartësisë, në Art dhe Kulturë. Gjithashtu në bashkëpunim me grupet e interesit, janë marrë një sërë masash për rritjen e audiencave përmes zhvillimit të disa programeve dhe veprimtarive me fokus Edukimin përmes Artit dhe Kulturës. Rëndësi të vecantë zë puna e nisur për Programin Analitik, me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor duke ju përafuar sa më shumë standarteve europiane, për saktësimin dhe plotësimin e vakumeve ligjore, në secilin prej ligjeve që Drejtoria jonë ka objekt të veprimtarisë.

Referuar produkteve A, B, C sipas Politikës së Programit 2015-2017

❖ ***(Produkti A) - Veprimtari të realizuara në institucionet e Artit dhe Kulturës:***

Pranë institucioneve qendrore të artit dhe kulturës në vend u realizuan plotësisht kalendarët artistikë të parashikuar dhe miratuara pranë bordeve artistike. Në secilin prej 6 institucioneve, Programet artistike shfaqën cilësi dhe intergritet ta lartë me prurjet e reja dhe krijimtarinë artistike. Përsa i përket implementimit të programit të ri, të Edukimit përmes Kulturës, ndjeshëm dhe dukshëm ka qenë gjithpërfshirja e aktorëve dhe është pritur me interes të lartë nga publiku. *Teatri i Operas dhe Baletit dhe Ansamblit Popullor ;Teatri Kombëtar Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullav Cirku Kombëtar Arkivi Qëndror Shqiptar i Filmit Qendra e Realizimit të Veprave të Artit*

❖ ***(Produkti B) - Veprimtari të realizuara me fondet e programit Art-Kulturë: zëri 604***

Realizimi i dyThirrjeve për projekt-propozime, në Art-Kulturë si dhe “Udhëzuesve përkatës” mbi procedurat që ndiqen, në kuadër të mbështetjes dhe administrim i fondit publik për projektet artistike dhe kulturore, për Fazën e I-rë dhe të II-të, në 12 mujorin e vitit 2014.

Drejtoria e Krijimtarisë dhe Edukimit përmes Kulturës në bashkëpunim të ngushtë me operatorët e artit dhe kulturës në vend, të cilët u mbështetën përmes propozimeve të tyre, me projekte artistiko-kulturore, arriti të përmbyllë me sukses 78 projekte artistike, ku secili prej tyre pati

produkt të mirëfilltë artistik si dhe siguroi ngritje kapacitetesh për gjeneratën e re të arti dhe kulturës.. Këto projekte patën shtrirje brenda dhe jashtë

Sipas disiplinave : **Festivale 29; evente multikulturor 4; arte bashkokohore 6; konferenca 2; reportazh 1; shfaqje teatrale 5; program televiziv 1; ëorkshop 1; botim 6; dokumentar 1; stacion radiofokin 1; hulumtim / studim 3; CD muzikore 1; simpozium kulture 1; reviste online 1; muze virtual 1; filozofi 1; ekspozita 4; musical 1; muzikë kontemporane 1; projekt teatror 1; konkurs 1.** Për vitin 2014 , shprehemi se projektet përfituese ishin me gamë të gjerë veprimtarie . Risi në të dyja thirrjet ishin projektet në disiplinën e hulumtimit dhe krijimit të strukturave virtuale. Një tjetër gjetje, që shfaqti sukses, ishin projektet të cilat u zhvilluan pranë hapësirave të lëna në harresë, të cilat u kthyen në hapësira krijuese kreative për vetë artistët dhe artëdashësit. Për secilin projekt të mbështetur nga MK ka patur fushatë monitorimi, ku specialistët e fushës kanë mbajtur relacionet dhe dokumenatcionin justifikues. Këto projekte sollën një impakt të kënaqshëm dhe të qëndrueshëm për vet organizatorët, grupet e interesit si dhe institucionet e artit dhe kulturës.në vend. Audienca direkte e aktiviteteve artistike arriti deri në 45.000 artëdashës, e duke e tjekaluar këtë shifër përmes audiencës Televizive, Radiove Lokale dhe ato Kombëtare, pa lënë mënjanë audiencën virtuale.

Projekte të tjera të realizuara nga programi Art-Kulturë, për 12 mujorin e vitit 2014:

Në kuadër të vizitës së Papa Franceskut në Shqipëri më datë 21 shtator 2014, Ministria e Kulturës në bashkëpunim me institucionet qendrore të Artit dhe Kulturës oragnizuan ndër të tjera, aktivitetet si më poshtë:

“Aktivitete artistike Ëaiting for the Pope”

Koncert dhe lexime/recitime të materialeve poetike nga autorë me profil religjioz TKOB dhe TK. (Durrës dhe Tiranë)

Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” ,

Mbrëmje poetike me poezi të De Radës dhe me muzikë arbëreshe.

Believe it or not!

Program Filmash të përzgjedhur nga Doku fest. Shfaqje e prodksioneve të tre filmave religjioz pranë MHK

Galeria Kombëtare e Artev

Ekspozitë e piktorit Lin Delija "Historia e tij është takimi i Artit me Kishën"

Arkivi Qëndror i Filmit Shqiptar dhe Muzeu Historik Kombëtar

- Ringjallja - Dokumentar me material arkivore mbi besimin fetar, ndalimin nga regjimi komunist dhe ringjallja e tij me ardhjen e demokracisë.
- Nënë Tereza, dokumentar mbi jetën dhe aktivitetin bamirës te Nënë Terezës, 2003, regjia Kujtim Gjonaj, pranë AQSHF, me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave të Tiranës, me fokus Edukimin përmes Kulturës.
- Aleluja, Dokumentar retrospektive mbi vizitën e Papës Gjon Pali II dhe Nënë Terezës në Shqipëri në vitin 1992.

Gjithashtu në kuadër të Festimeve të 70 vjetorit të Çlirimit të vendit , u zhvilluan veprimtari të shumta artistike ndër të tjera: Bazuar në VKM nr. 647, datë 8.10.2014, *“Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për disa institucione për festimet e 70 vjetorit të çlirimit të vendit”*.

1. Shpallja e Motos dhe Logos së 70 Vjetorit të Çlirimit;
2. Festivali i Dritave
3. Ekspozitë në hollin e Kryeministrit;
4. Ekspozitë fotografike në arkadën e TKOBAP;
5. Ekspozitë në bunkerin antibërthamor Linzë, (objekti 0774);

Projekti Bunkart konsistoi në hapjen për herë të parë, për publikun e gjerë, të bunkerit antibërthamor të nomenklaturës komuniste. Brenda ambienteve të tij , u rikonceptuan hapësira kreative të cilat u përcollën përmes ekspozitave dhe instalacioneve të arteve pamore. Ky objekt tashmë është rikthyer në një muze të arteve bashkëkohore për artistët e rinj. Hapja e tij vazhdon të shfaqë interes të lartë . për publikun brenda dhe jashtë vendit., por në veçanti për artistët e rinj të cilët janë të interesuar të realizojnë veprimtari artistike pranë këtyre hapësirave të reja..

Krijimi dhe aktivizimi i portalit www.artport.al

Në kuadër të fushës së veprimtarisë së Ministrisë së Kulturës, duke synuar zhvillimin e politikave mbështetëse në fushën e artit bashkëkohor, Drejtoria e Krijimtarisë dhe Edukimit përmes Kulturës, së shpejti konkretizon punën e nisur muaj më parë, në lidhje me krijimin e një portali që do të pasqyrojë të gjitha të dhënat e subjekteve që veprojnë në fushën e artit bashkëkohor, në një platformë dixhitale publike. Kjo iniciativë është bazuar në disa eksperiencat të suksesshme ndërkombëtare, kushtuar artit bashkëkohor, si: INDEX Berlin <http://www.indexberlin.de/> dhe Berlinartlink www.berlinartlink.com.

Në proces pune është trajnimi i stafit, (*specialistë të Drejtorisë-përdoruesit-users*), mbi mënyrat e hyrjes, hedhjes së informacionit, pasurimin dhe përditësimin e tij në kohë reale si dhe të gjithateknikat e domosdoshme për një efikasitet të lartë në funksionimin e www.artport.al.

Dita ndërkombëtare e muzikës, 21 qershor 2014

Përfshirja në axhëndën zyrtare të Ministrisë së Kulturës, e *Festës së Muzikës*, e cila u realizua në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Galerinë Kombëtare të Arteve, Liceun Artistik “Jordan Misja”, Akademinë “Hollyëod”, bazuar në Urdhrin e Ministres, me nr.151Prot, Dt.20.06.2014, *“Për financimin e projektit, Dita ndërkombëtare e muzikës, 21 qershor 2014”, që do të zhvillohet në Tiranë”*. Ky projekt u paraqit si projekt-propozim nga “PIK Creative”, Sh.p.k, platforma që paraqiste një gamë të gjerë veprimtarish artistike në treen,

ambinete publike, e cila u zhvillua përmes, krijimit të skenave të vogla, me muzikë të përzgjedhur në zonën e ish-bllokut dhe pranë Liceut Artistik, publik. Koncert nga artistë profesionistë, si Dren Abazi@Zig Zag Band, që u zhvillua po atë ditë pranë Galerisë Kombëtare të Arteve. Të tjera shfaqje artistike të shtrira në kohë dhe hapësirë si: pranë Parkut Rinia, Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Rruga “Ibrahim Rugova”, Muzeu Historik Kombëtar, Parku Kombëtar-Liqeni, Rruga Ismail Qemali, etj.

Memorandum Mirëkuptimi mes Ministrisë së Kulturës dhe Këshillit Britanik në Shqipëri.

Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit kulturor mes Ministrisë së Kulturës dhe Këshillit Britanik në Shqipëri, marrëveshje e cila ka në fokus të saj, asistencë profesionale nga ekspertë të jashtëm, me qëllim përmirësimin e performancës në institucionet kulturore në Shqipëri (*teatro, muze dhe galeri*), përmes rritjes së numrit të vizitorëve/ spektatorëve, (audience), në terren dhe bashkëveprim me partnere lokale dhe ndërkombëtare.

Projekti i fundvitit Magjite e skenës

Në kuadër të aktiviteteve kulturore të zhvilluara nga Institucionet më të rëndësishme të artit dhe kulturës në vend për vitin 2014, si dhe në nderim të artistëve dhe praktikave më të mira të realizuara në skenën shqiptare, institucioneve më të rëndësishme publike të artit kulturës dhe trashëgimisë kulturore në vend, si : *TKOBAP, QKKFTK, TK, GKA, TKEKS, CK, MHK, DRRK* në rrethe etj, të cilët kanë zhvilluar një programacion mjaft të larmishëm gjatë sezonit artistik të vitit 2014, duke u vlerësuar nga një audencë e gjerë, e reflektuar kjo dhe në shtypin e shkruar dhe mas-media, përmes impaktit të matshëm dhe vlerësimit mjaft të lartë për secilin aktivitet të realizuar përgjatë këtij viti.

❖ (Produkti C) - Përfaqësimi në programe dhe evenimente ndërkombëtare:

Promovimi i imazhit dhe artit shqiptar në arenën ndërkombëtare si dhe sjellja e eksperiencave më të mira të artistëve shqiptarë që jetojnë jashtë në skenat e vendit si psh:

1. Përfaqësimi i Shqipërisë në Bienalen e Arkitekturës, Venecia, Itali, e cila u çel më datë 7 qershor 2014, e që do të vazhdojë deri më 23 nëntor 2014. Përfaqësimi u realizua me sukses nga 2 kuratorët e pavionit shqiptar”, Znj. Jonida Turani dhe Z. Stefano R. Pansera. Pavioni i Shqipërisë në këtë Bienale, titullohet “Monumente të Mundshëm Ardhmërisht të Perealizuara”, dhe u prezantuan punët e dy artistëve shqiptarë “Penthouse” (Shtesat), një seri pikturash nga Edi Hila dhe “The Column” (Kolona), video/instalacioni nga Adrian Paci. Prezantimi me sukses i Shqipërisë në këtë eveniment të rëndësishëm artistiko-kulturor, pati jehonë gjithëpërfshirëse në fushën e artit vizual botëror, përmes mas-medias, shtypit të shkruar, grupeve artistike elitare botërore, rrjeteve sociale.

2. Pjesëmarrja e QKK, në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit, Karlovy Vary 2014, Çeki, me filmin BOTA, në mbështetje të prezantimit të filmit shqiptar, në arenën ndërkombëtare, Ky film, me regji dhe skenar të Iris Elezi dhe Thomas Logoreci, pati premierën dhe suksesin botëror në festivalin

prestigjioz të Karlovy Vary-t, që u zhvillua në Çeki, përgjatë datave 4 - 12 Korrik 2014. Filmi, BOTA, produksion i Era Film, është filmi i bashkëfinancuar nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Ministria e Kulturës Italiane, mbështetur dhe nga Euroimages.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,